



ORDO FRATRUM MINORUM

Provinca Françeskane “Zoja Nunciatë” në Shqipëri e Mal të Zi

Kuria e Provincës, L. Vasil Shanto, Rr. At' Gjergj Fishta 22, 4001 Shkodër - Albania
Tel./fax: +355 222 42725, E-mail: sekretariaekustodies@gmail.com

DEKLARATË

Provinca Françeskane “Zoja Nunciatë” ka ndjekur me vëmendje polemikën e ngritur në media dhe në komunitet mbi projektin e Kishës së Laçit dhe shpreh keqardhjen për keqinformimin deri në abuzim që është bërë duke dëmtuar direkt ose indirekt reputacionin e Kishës, si dhe duke ngritur pikëpyetje që nuk kanë vend.

Sqarojmë se nuk është aspak e vërtetë që projekti për territorin e Kishës së Shna Ndout, shumë i përfolur në media, nuk ka kushtuar aq sa deklarohet përmes atyre shifrave abuzive që nuk dihet mbi ç’bazë janë mbështetur.


Projekti është miratuar nga një komision i posaçëm i strukturave të Provincës Françeskane dhe ecuria e tij mbikëqyret nga Kuria Gjenerale në Romë që është Enti epror i Provincës Françeskane, ndërkohë jemi në pritje prej 3 vitesh të miratimit të lejes zhvillimore.

Deklarojmë se Kisha e Shna Ndout në Laç-Sebaste do t’i nënshtrohet një ndryshimi rrënjësor. Kisha ekzistuese nuk do të çenohet, ajo ruhet e paprekur nga projekti. Nuk do të ketë një kishë në bodrum, por do të ketë një vend lutje që në terminologjinë kishtare quhet Kripta, dhe mbi të do të ngrihet Kisha e re, me dëshirën për ta kthyer në një vend të mirëfilltë pelegrinazhi me dinjitetin e një vendi të shenjtë dhe të hapur për të gjithë personat që duan të jenë më afër Zotit.

Garantojmë të gjithë komunitetin e besimtarëve katolikë, por dhe mbarëshqiptar, se nuk do të ketë asnjë humbje vlerash në projektin e ri, përkundrazi jemi të bindur se projekti do të jetë vitalizues për Kishën e Shna Ndout në Laç dhe të gjithë së bashku do ta gëzojmë këtë vend të shenjtë e të bekuar.



Shkodër, më 01.10.2025


Fra Pashko Gojcaj, OFM
Ministër Provincial